



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.79 dt.15.05.1997

**PER
DHENIE FOND PAGE NDERMARRJES TE PRODHIMIT
TE ENEVE TE BAKRIT**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.15.05.1997, shqyrtoi relacionin për dhënie fond page për Ndërmarrjen e Prodhimit të Enëve të Bakrit paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik (Sektori i Zhvillimit Industrisë). Këshilli Bashkiak mbështetur në kopetencat që i jep ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” Nr.7582, dt.10.06.1992, neni.14, pika.10 në zbatim të Vendimit të Këshillit Ministrave Nr.673, dt.29.11.1995 “Për kriteret e përdorimit të të ardhurave të organeve të pushtetit lokal”, pika.2, nëndarja.”a”.

VENDOSI

1. Ndërmarrjes së Prodhimit të Enëve të Bakrit ti jepet çdo muaj fondi prej 6.198.740 lekësh për pagesën e drejtorit, shefit të financës, përgjegjësit të repartit, magazinier arkëtar dhe 4 roje. Kuotata e pagave të caktohen në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.45, dt.27.03.1997 të verifikimit të pagave për ndërmarrjet që kalojnë në konservim.
2. Pagesa të fillojë nga 1 janari 1997 deri në shpalljen e privatizimit të Ndërmarrjes.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Financës.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

